



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.204/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues, Kymete Kicaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.204/2025 e datës 26.01.2025,
- II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,500.00 (katërmijë e pesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.01.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.204/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 25.01.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicën e Veriut kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të partisë Lista Serbe, në rrugët publike "Sutjeska" dhe "Milan Shuflai" në Mitrovicën e Veriut. Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti politik Lista Serbe ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Si provë ka bashkangjitur, fotografit që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Më datë 26.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lista Serbe, me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 27.01.2025 në ora 16:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur, subjekti politik Lista Serbe ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kanë theksuar se nëpërmjet një inspektimi në terren

nga aktivistët tanë kemi konstatuar se numri më i madh i materialeve propagandistike ndodhen në banesa private, shtëpi dhe lokale dhe se aktivistët tanë kishin leje nga pronarët e objekteve të lartpërmendura për te vendosur materiale reklamuese në prona private. Me tutje parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se fotografia numër 1 dhe 2 është e vështirë për tu identifikuar se ku ndodhet ndërsa fotografia numër 3 tregon qartë se është një shtëpi familjare përkatësisht pronë private e dikujt, fotografia 4, 5 dhe 6 tregojnë qartë se materiali propagandistik është vendosur në dritaret e banesave ose shtëpive të aktivistëve tanë që i bie se janë në pronësi private. Sa i përket fotografisë 7 dhe 8, behët fjalë për material propagandistik që është vendosur në një kioskë në pronësi private ndërsa fotot numër 9 dhe 10 janë ngjitur në barnatoren "Panta Rei" dhe si subjekt kemi lejen verbale të vetë pronës së Pallatit. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar edhe se ankuesi nuk e ka bërë ankesën brenda afatit kur ka ndodhur shkelja përkatësisht brenda 48 orëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

-Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik Lista Serbe, në Mitrovicën e Veriut ka shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, hapësirat publike konkretisht në objektet dhe në hapësirat/rrugët publike. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "*1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli shqyrtoi edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lista Serbe në të cilën e kundërshton ankesën dhe ku thekson se, numri më i madh i materialeve propagandistike ndodhen në banesa private, shtëpi dhe lokale dhe se aktivistët tanë kishin leje nga pronarët e objekteve të lartpërmendura për te vendosur materiale reklamuese në prona private, për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara, për faktin se posteret janë vendosur në hapësirën e jashtme të objekteve të banimit kolektiv, dhe se për këtë rast duhet leje e veçantë, përkatësisht, pëlqim nga Drejtoria përkatëse të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës së Veriut. Kurse në rastet kur objektet janë private, atëherë duhet të sigurohet pëlqimi me shkrim nga pronari-shfrytëzuesi i objektit, mirëpo parashtruesi i përgjegjës në ankesë nuk ka arritur ta bashkëngjisë ndonjë pëlqim më shkrim, e që këto leje apo marrëveshje nuk janë siguruar nga subjekti politik Lista Serbe.

Paneli po ashtu vlerësoi edhe pretendimet tjera nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se të njëjtat nuk janë provuar me asnjë prove të vetme.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi ë përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, që konsiston në faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.204/2025 më datë 28.01.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.